

URDHËR
Nr. 650, datë 1.11.2022

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe vendimit nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për të gjitha procedurat e prokurimit publik me fonde buxhetore për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, z. Erzen Tola.

2. Kompetencat e deleguara të titullarit të autoritetit kontraktor të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në zbatim të dispozitave ligjore për prokurimin publik, do të ushtrohen për një periudhë të pacaktuar nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, deri në shfuqizimin e këtij urdhri, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegates apo të deleguar.

3. Urdhri nr. 300, datë 7.10.2020, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri z. Erzen Tola, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi